



**INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË LIRË TË  
GJIMNAZIT**

**FUSHA: ARTE**

**LËNDA: KËRCIM**

**KODI: 1.3.11.Z**

**PROGRAMI I MODULIT KËRCIM**

**PËR KLASËN E 11<sup>të</sup>**

**TIRANË, DHJETOR 2009**

Ky modul luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive estetike dhe profesionale të nxënësve në fushën e kërcimit. Rritja e mëtejshme e njohurive që kanë për kërcimin dhe veprimtaritë praktike që nxënësit do të kryejnë gjatë zhvillimit të këtij moduli do t'i nxisin ata të përfshihen në jetën artistike të shkollës dhe në komunitet. Njëkohësisht realizimi i këtij moduli do t'i ndihmojë ata si në zhvillimin etik, fizik, social dhe estetik, ashtu edhe në njohjen e kulturës kombëtare dhe asaj botërore.

Ky modul zhvillohet përmes disa lloj kërcimesh të cilat janë: *valsit, kërcimi modern rumba, samba dhe kërcimi popullor*. Të gjitha këto kërcime kanë kërkesat dhe specifikat e tyre të cilat realizohen secila në tre pjesë:

në pjesën e parë *bashkërendimi i praktikës me historinë e këtyre kërcimeve*,

në pjesën e dytë *realizohet përvetësimi teknik i kërcimit dhe*

në pjesën e tretë *interpretimi emocional i këtyre kërcimeve*.

## 1. SYNIMI I MODULIT

Program i modulit "Kërcimi" synon:

që nxënësit të kuptojnë që çdo epokë ka kërcimet e veta që shprehin mënyrën dhe stilin e kërcimit të kohës. Në këtë modul përmes kërcimeve të zgjedhura, nxënësit fitojnë natyrshmëri, shprehje, komunikim dhe përvojë skenike. Ky modul u jep mundësinë nxënësve të demonstrojnë aftësitë e tyre kërcyese në veprimtaritë shkollërore, familjare apo evenimentet që organizon komuniteti.

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij moduli, nxënësi, -ja duhet të jetë i/e aftë :

- të kuptojë rëndësinë e kërcimit vetëm dhe në grup;
- të zhvillojë aftësinë e bashkëpunimit në grup;
- të demonstrojë elementet bazë në një nivel të kënaqshëm të
  - *valsit*,
  - *rumbës*,
  - *sambës*,
  - *kërcimit modern* apo dhe të
  - *valles popullore*;
- të përshkruajë zhvillimin e historisë së *valsit, rumbës, sambës, kërcimit modern dhe valles popullore*;
- të vlerësojë dhe vet vlerësojë gjatë procesit të kërcimit;
- të formojë aftësi estetike, artistike dhe kritike;
- të përfshihet në jetën kulturore të shkollës;
- të zhvillojnë më tej aftësitë e veta individuale artistike, duke i parë ato si një mundësi për profesionin e tyre të ardhshëm.

## 3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

36 javë x 1 orë = 36 orë<sup>1</sup>

### Linja 1: Valsi

**Përshkrimi i linjës:** Kjo linjë i njih nxënësit me historinë dhe me teknikën bazë të kërcimit të valsit. Nxënësit përveçse do të mësojnë dhe aftësohen në kërcimin e valsit, ata do të kuptojnë vlerën e valsit në jetën sociale. Gjithashtu ata do të njihen shkurtimisht me historinë e lindjes dhe zhvillimit të valsit, do të realizojnë kërcimin e valsit duke kuptuar marrëdhënien damë – partner gjatë kërcimit, duke u orientuar në hapësirë dhe në kohë, duke zbatuar hapat bazë të valsit, duke ndjekur muzikën në kohën  $\frac{3}{4}$ , muzikë në të cilën kërcëhet vals. Mësimi i valsit do t'u japë mundësinë të shfaqin aftësitë e tyre artistike, duke interpretuar vals në veprimtaritë shkollore, shoqërore dhe familjare.

Orë të sugjeruara<sup>2</sup>: 12 orë

Linja	Objektiva
Valsi	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• të argumentojë vlerën e kërcimit të valsit në jetën sociale;</li><li>• të shpjegojë dy llojet bazë të valsit vjenez dhe anglez;</li><li>• të demonstrojë rëndësinë e lëvizjes së parë në kohën e parë me një theks të fortë në kohën <math>\frac{3}{4}</math>;</li><li>• të kuptojë ritmin e valsit përmes dëgjimit të pjesëve muzikore në kohën <math>\frac{3}{4}</math>;</li><li>• të përvetësojë dinamikën e valsit;</li><li>• të realizojë përmes lëvizjeve bazë të valsit:<ul style="list-style-type: none"><li>- vendosja në çift në pozicionin e gjashtë me dy gjunjët e thyera,</li><li>- vendosja e kokës dhe e trupit,</li><li>- hapi bazë kuadrat para, mbrapa,</li><li>- hapi bazë me rrotullim nga e djathta dhe e majta,</li><li>- këmbët shtyjnë njëra - tjetrën kur bashkohen po pa u hedhur, vetëm me rrëshqitje,</li><li>- këmbët mbyllen në pozicionin e gjashtë,</li><li>- improvizim me lëvizjet e mësipërme;</li></ul></li><li>• të bashkërendojë <i>historinë e valsit me praktikën konkrete</i>;</li><li>• të realizojë përvetësimin <i>teknik të këtij valsit</i>;</li><li>• të realizojë vals në duke kombinuar të gjitha lëvizjet duke</li></ul>

<sup>1</sup> 36 orët do të përmbushen duke bashkuar orët e tri kërcimeve të ndryshme, dhe ku shuma e tyre do të japë 36 orë vjetore.

<sup>2</sup> Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të modulit (mësuesit) që të shtojë ose pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10% sipas nevojave të klasës.

	<p><i>interpretuar emocionalisht</i> valsin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të zhvillojë aftësitë kërcyese, duke performuar lirshëm para klasës të improvizuar si publik <i>vals</i>in;</li> <li>• të respektojë punën në grup.</li> </ul>
--	--

## Linja 2: Kërcimi Modern

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë i njeh nxënësit me disa nga rrymat më të njohura të kërcimit modern dhe me historinë e krijimit të tyre. Ekzekutimi i një kërcimi modern u krijon nxënësve një atmosferë sociale, i ndihmon ata ta shikojnë kërcimin si një mënyrë për zhvillimin e aktivitetit fizik, përdorin trupin me më shumë elasticitet, të ketë një trup më të bonifikuar duke krijuar kështu një konfidencë me publikun dhe bashkë moshatarët gjatë kërcimit, orientohen më mirë në hapësirë dhe në kohë, arrijnë të shpjegojnë realizimin e hapave të këtij lloji kërcimi si dhe përdorin kërcimin modern dhe në aktivitet të tjera jashtë shkollore.

**Orë të sugjeruara: 12 orë**

Bloku tematik	Objektiva
<b>Kërcimi modern</b>	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë shkurt historikun e lindjes së kërcimit modern, stilet kryesore, muzikën që përdoret dhe pozicionet bazë;</li> <li>• të demonstrojë kuptimin e lëvizjeve të kërcimit modern: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pozës kolaps,</li> <li>- lëvizjet në hapësirë horizontalisht dhe vertikalisht,</li> <li>- lëvizjet e ndryshme të pjesëve të ndryshme të trupit,</li> <li>- përdorimit të lëvizjeve të vështira ritmike dhe sinkope,</li> <li>- koordinimit dhe kombinimit të ndërsjelltë të muzikës me kërcimin të cilat shërbejnë për realizimin e këtij kërcimi;</li> </ul> </li> <li>• të kryejë saktë (contraction dhe release) marrja dhe nxjerrja e frymës;</li> <li>• të realizojë saktë nivelet kryesorë të kërcimit modern si: lëvizjet horizontalisht dhe vertikalisht;</li> <li>• të demonstrojë realizimin e lëvizjeve të ndryshme bazë në hapësirë, hedhjeve dhe rrotullimeve;</li> <li>• të bashkërendojë historinë e kërcimit modern me praktikën konkrete;</li> <li>• të realizojë përvetësimin teknik të kërcimit modern;</li> <li>• të zhvillojë aftësitë kërcyese, duke performuar lirshëm para klasës së improvizuar si publik një kërcim modern dhe duke interpretuar emocionalisht këtë kërcim;</li> <li>• të respektojë punën në grup.</li> </ul>

### Linja 3: Kërcimi popullor shqiptar

**Përshkrimi i linjës:** Kjo linjë i njeh nxënësit me elemente të kërcimeve popullore shqiptare. Gjithashtu nxënësit përmes mësimit të këtyre kërcimeve vlerësojnë veprat koreografike të popullit shqiptar, zhvillojnë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të motiveve popullore të valleve, dallojnë muzikën e trevave të ndryshme shqiptare nxënësit do të ekzekutojnë 3 valle popullore, duke realizuar motivet karakteristike të secilës valle.

**Orë të sugjeruara: 12 orë**

Bloku tematik	Objektiva
<b>Kërcimi popullor shqiptar</b>	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>të realizojë 3 valle popullore shqiptare:</li></ul> <p><b>Vallja pagonishte</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- kërcëhet vajza dhe djem bashkë,</li><li>- koha muzikore 7/8 (3+2+2),</li><li>- hapat bazë për vajza dhe djem,</li><li>- udhëhiqet nga korifeu,</li><li>- hapat me rrotullim të korifeut,</li><li>- konfiguracione të ndryshme gjatë valles.</li></ul> <p><b>Vallja e napolonit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- koha muzikore 2/4,</li><li>- kërcëhet nga një vajzë e një djalë,</li><li>- hapa të thjeshtë, hap dhe ndërrim hapi,</li><li>- duart dhe lëvizjet karakteristike të duarve janë përpara gjoksit të hapura,</li><li>- djali mban shaminë në dorë dhe i rrotullohet vazhdimisht vajzës,</li><li>- përkuljet e trupit,</li><li>- dridhjet në ajër,</li><li>- kapërcimet dhe ndërrimet e këmbëve në ajër.</li></ul> <p><b>Vallja e Librazhdit</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- koha muzikore 2/4,</li><li>- kërcëhet djem dhe vajza bashkë,</li><li>- shoqërohet muzika vazhdimisht nga daullja,</li><li>- realizohet tundja e supeve dhe e gjoksit nga të dyja palët gjinore,</li><li>- pozicionet e larmishme të duarve para dhe pas shpinës,</li><li>- mbahen pozicionet duarve të hapura anash si dhe krijohen tundjet e supeve dhe gjoksit,</li><li>- kërcëhen hapat me shkëputje nga toka ose bëhen shpesh dhe ndërrimet e këmbëve në ajër.</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>Të dallojë motivet kryesore të këtyre valleve;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të kërcejë motivet karakteristike të këtyre valleve;</li> <li>• të demonstrojë përvetësimin e saktë të këtyre motiveve popullore;</li> <li>• të trajtojë natyrën dhe karakterin e motiveve të valleve nga tre krahinat që i përkasin;</li> <li>• të vlerësojë rolin e solistëve në valle;</li> <li>• të bashkërendojë historinë e këtyre valleve me praktikën konkrete;</li> <li>• të realizojë përvetësimin teknik të këtyre valleve;</li> <li>• të interpretojë emocionalisht qoftë edhe njëri nga këto valle popullore;</li> <li>• të zhvillojë aftësitë kërcyese, duke performuar lirshëm para klasës të improvizuar si publik njëri nga vallet popullore;</li> <li>• të respektojë punën në grup.</li> </ul>
--	--

#### Linja 4: Kërcimi Rumba

**Përshkrimi i linjës:** Kjo linjë i njeh nxënësit me historinë dhe teknikat bazë të kërcimit të rumbës. Nxënësit përveçse do të mësojnë dhe do të aftësohen në kërcimin e rumbës ata do të kuptojnë vlerën e rumbës në jetën e tyre. Gjithashtu, ata do të njihen shkurtimisht me historinë e lindjes dhe zhvillimit të rumbës, këtij kërcimi kubanez me prejardhje spanjolle si shprehjet e karakterit jetësor, ku ndikimi evropian në muzikë do të ndjehet shumë edhe pse rrënjët muzikore ishin afrikane. Ata do të realizojnë kërcimin e rumbës duke kuptuar marrëdhënien damë – kavalier gjatë kërcimit, duke respektuar dhe duke zbatuar figurat dhe hapat bazë të këtij kërcimi, duke ndjekur muzikën në kohën 2/4, muzikë në të cilën kërcëhet ky kërcim. Mësimi i rumbës do t’u japë mundësinë të shfaqin aftësitë e tyre artistike, duke i interpretuar ato në veprimtaritë shkollore, shoqërore dhe familjare.

**Orë të sugjeruara: 12 orë**

Bloku tematik	Objektiva
Rumba	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të argumentojë vlerën e kërcimit të rumbës në jetën sociale;</li> <li>• të shpjegojë shkurt historikun e lindjes së rumbës;</li> <li>• të respektojë gjatë kërcimit të rumbës figurat bazë të këtij kërcimi;</li> <li>• të respektojnë rregullin bazë të lëvizjeve të kofshëve në mënyrë të rrjedhshme dhe elegante;</li> <li>• të kuptojë ritmin e rumbës në kohën 2/4;</li> <li>• të përvetësojë dinamikën e rumbës;</li> <li>• të realizojë përmes figurave bazë këto lëvizje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Figura e parë:</i> pozicioni fillestar, partnerët qëndrojnë me fytyrë përballë njëri-tjetrit të kapur për dore, figura e mbyllur: shpina drejt distanca është në hapësirën rreth 15 cm, këmbët janë të hapura 30cm, majat të</li> </ul> </li> </ul>

	<p>kthyerë nga jashtë,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Figura e dytë</i>: hap i hapur - 6 hapa, 8 lëvizje,</li> <li>- <i>Figura e tretë</i>: Allemanda - 6 hapa, 8 lëvizje, (të dyja variantet e allemandës)</li> <li>- <i>Figura e katërt</i>: Allemanda - 6 hapa, 8 lëvizje,</li> <li>- <i>Figura e pestë</i>: dorë më dorë – 9 hapa, 12 lëvizje,</li> <li>- <i>Figura e gjashtë</i>: lodër rrotulluese (fuga) në të majtë – 3 hapa, 4 lëvizje,</li> <li>- <i>Figura e shtatë</i>: “Pah” (Hap) brinjazi – 6 hapa, 8 lëvizje,</li> <li>- <i>Mbyllja e kërcimit</i> – kthimi i lëvizjeve në gjendjen fillestare, ku kërcimtarët bashkojnë këmbët, duke i bërë lëvizjet e kofshëve të rrjedhshme dhe harmonike.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të bashkërendojë <i>historinë e rumbës me praktikën konkrete</i>;</li> <li>• të realizojë përvetësimin <i>teknik të këtij kërcimi</i>;</li> <li>• të realizojë rumbën duke kombinuar të gjitha lëvizjet duke <i>interpretuar emocionalisht</i> atë;</li> <li>• të zhvillojë <i>aftësitë kërcyese</i>, duke performuar lirshëm para klasës të improvizuar si publik <i>rumbën</i>;</li> <li>• të respektojë partnerin/partneren gjatë kërcimit.</li> </ul>
--	--

### Linja 5: Samba

**Përshkrimi i linjës:** Kjo linjë i njeh nxënësit me historinë dhe me teknikat bazë të kërcimit të sambës. Nxënësit do të mësojnë dhe do të aftësohen në kërcimin e sambës, si dhe do të kuptojnë vlerën e saj në jetën e tyre. Gjithashtu, ata do të njihen shkurtimisht me historinë e lindjes dhe zhvillimit të sambës, të këtij kërcimi që është emblema e Brazilit dhe karakteristikë e karnavaleve të Rio de Zhaneros. “Sjemba” do të thotë “fjongo” e cila imiton ose ka të bëjë me tundjen. Ata do të realizojnë kërcimin e sambës duke kuptuar marrëdhënien damë – kavalier gjatë kërcimit, si dhe duke respektuar figurat e kërcimit, duke zbatuar figurat dhe hapat bazë të këtij kërcimi, duke ndjekur muzikën në kohën 2/4, muzikë në të cilën kërcëhet ky kërcim. Mësimi i sambës do t’u japë mundësinë të shfaqin aftësitë e tyre artistike, duke interpretuar atë në veprimtaritë shkollore, shoqërore dhe familjare.

**Orë të sugjeruara: 12 orë**

Blloku tematik	Objektiva
	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të argumentojë vlerën e kërcimit të sambës në jetën sociale;</li> <li>• të shpjegojë shkurt historikun e lindjes së sambës;</li> <li>• të demonstrojë kërcimin në të kundërtën e akrepave të orës;</li> </ul>

<p><b>Samba</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të respektojë gjatë kërcimit të sambës figurat bazë të këtij kërcimi;</li> <li>• të kuptojë ritmin e sambës në kohën 2/4;</li> <li>• të përvetësojë dinamikën e sambës;</li> <li>• të realizojë përmes figurave bazë këto lëvizje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>figura e parë</i>: hapi bazë, mbrapa 4 hapa. Pozicioni fillestar, ku çifti vendoset përballë njëri – tjetrit, të kapur e të mbyllur në distancën 15 cm larg, me shpinë të drejtë dhe gjunjë të thyera,</li> <li>- <i>figura e dytë</i>: 6 hapa, 8 lëvizje mbrapa,</li> <li>- <i>figura e tretë</i>: në të majtë e në të djathtë – 6 hapa, 8 lëvizje. Kryqëzimi i këmbëve sipas modelit wisk,</li> <li>- <i>figura e katërt</i>: në vend - 6 hapa,</li> <li>- <i>figura e pestë</i>: lëvizja brinjazi – 3 hapa,</li> <li>- <i>figura e gjashtë</i>: bota/foga – 9 hapa, 12 lëvizje,</li> <li>- <i>figura e shtatë</i>: kavalieri dhe dama – lëvizja sustë,</li> <li>- <i>mbyllja e kërcimit</i>;</li> </ul> </li> <li>• të bashkërendojë <i>historinë e sambës me praktikën konkrete</i>;</li> <li>• të realizojë përvetësimin <i>teknik të këtij kërcimi</i>;</li> <li>• të realizojë sambën duke kombinuar të gjitha lëvizjet duke <i>interpretuar emocionalisht</i> atë;</li> <li>• të zhvillojë <i>aftësitë kërcyese</i>, duke performuar lirshëm para klasës të improvizuar si publik sambën;</li> <li>• të respektojë partnerin/partneren gjatë kërcimit.</li> </ul>
---------------------	---

#### 4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E MODULIT

Programi i lëndës me zgjedhje të lirë është i detyrueshëm vetëm për nxënësit që e zgjedhin atë. Moduli “ Kërcimi ” është hartuar për t’u mësuar nxënësve tri ndër pesë kërcimet e servitura përgjatë këtij moduli dhe që i përkasin stileve të ndryshme: *vals, kërcimi modern, rumba, samba* dhe ai *popullor shqiptar*. Ai zgjat 36 orë mësimore vjetore, nga të cilat mësuesit duhet të përzgjedhin tri nga këto 5 kërcime, duke përmbytur detyrimin vjetor.

Moduli në përmbajtjen e tij ka në bazë të saj këto elemente: *historinë e secilit kërcim, teknikën e kërcimit dhe interpretimi emocional të kërcimit*. Duke i përvetësuar këto tre elementë bëhet i mundur realizimi dhe interpretimi i kërcimeve. Në orët e para të çdo kërcimi rekomandohet, që theksi të vihet në përforcimin e zhvillimin e elementëve teknikë dhe mbas përvetësimit të tyre mund të kalohet në të dy elementët e tjerë që do të ndihmojnë në kuptimin më të mirë dhe të plotë të kërcimit të dhënë.

Në tri – katër orët e fundit të planifikuara për çdo kërcim rekomandohet të ekzekutohen kërcimet e mësuara para një publiku të caktuar që mund të jenë vetë nxënësit e klasës apo përpara një publiku më të gjerë që mund të jenë nxënësit e shkollës apo në një sallë koncerti (atje ku ka mundësi të realizohet kjo gjë). Kjo gjë i bën nxënësit të kuptojnë më mirë aftësitë e tyre, të përballen me emocionet dhe publikun, të kuptojnë përgjegjësitë që ata



duhet të kryejnë dhe të shikojnë këtë lëndë si mundësi për të bërë karrierë. Megjithëse moduli ka si përbërje tri kërcime të karaktereve të ndryshme rekomandohet që të lihet një hapësirë dhe për përsëritjen e elementëve të kërcimit të përvetësuar më parë.

Zbatimi i programit duhet të bëhet, duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

### **Objektivat**

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të performojnë çka përshkruhet tek objektivat.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësues/i,-ja duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

### **Orët mësimore**

Programi i kërcimit është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetorë të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shitesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

## **6. VLERËSIMI**

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e modulit dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në programin e modulit. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

- përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve inkurajuese gjatë mësimit të të mësuarit,
- korigjimin me takt të lëvizjeve të gabuara,
- inkurajimin për demonstrime kërcyese të ndryshme,
- evidentimin e realizimeve të lëvizjeve gjatë mësimit të kërcimeve,
- vlerësimin e nxënësit të talentuar duke e vënë në rolin e udhëheqësit të kërcimit (kryesisht tek pjesa e modulit që ka të bëjë me vallet shqiptare),
- vlerësimin për improvizimin më të mirë,
- vlerësimin e pjesëmarrjes aktive në klasë për realizimin e një veprimtarie artistike etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj, duke shfaqur nëpërmjet veprimtarish e produkteve të tjera, si: krijimi i një improvizimi të një kërcimi pavarësisht llojit që i përket; improvizimi në kohë dhe hapësirë, marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike - kulturore, që organizon shkolla etj. Në angazhimin e nxënësve me grupe, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesi duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive dhe aftësive të fituara të orëve të kaluara.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi për këtë modul bazohet kryesisht në nivelin e angazhimit, përkushtimit, nivelit e arritjeve personale, shfaqjes së shpirtit të kolektivitetit dhe përgjegjshmërisë, respektit ndaj interpretimit dhe arritjes së shokëve apo partnerit.